



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “TSR” Sh.P.K. të datës 23.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “179 Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal – LOT VI” me nr. të prokurimit 616-25-1800-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “TSR” Sh.P.K. të datës 23.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “179 Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal – LOT VI” me nr. të prokurimit 616-25-1800-2-1-1 ashtu që **ANULOHE**t njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me LOTIN VI në këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit LOTIN VI nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët tjera e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “TSR” Sh.P.K. (tutje “parashtuesi”) me datë 23.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “179 Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal – LOT VI” me nr. të prokurimit 616-25-1800-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtuesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtuesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtuesit janë cituar si në vijim:

Me datë 16.06.2025 AK ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e AK përmes ka njoftuar si në vijim:

Për LOT-VI Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës anulon për arsye nuk ka pasur oferta të përgjegjshme.

Në njoftimin B58 të AK, nuk është bashkangjitur asnjë letër standarde për tenderuesit e eliminuar për lotin 6 të këtij aktiviteti të prokurimit. Pra në njërin anë AK e ka anuluar aktivitetin kinse nuk ka oferta të përgjegjshme dhe në anën tjetër nuk ka treguar fare pse oferta janë qenka ofertë e papërgjegjshme.

Në të gjitha rastet kur AK e eliminon një ofertë si të papërgjegjshme, duhet të tregoj saktësisht se cilat janë ato kërkesa të dosjes së tenderit që nuk janë plotësuar dhe për shkak të cilave oferta është cilësuar si e papërgjegjshme. Në rastin konkret AK nuk ka treguar pse oferta janë qenka cilësuar si e papërgjegjshme.

Përndryshe duhet sqaruar se ne kemi përbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit pa asnjë përjashtim të vetëm. Po ashtu ne kemi ofertuar edhe me çmimin më të lirë.

Përmes 62 të LPP janë përcaktuar situatat kur mund të anulohet një aktivitet të prokurimit në rast se nuk parashtrohet oferta të përgjegjshme. Mirëpo në rastin konkret oferta janë jo vetëm që është e përgjegjshme por është edhe me çmimin më të lirë nga të gjitha ofertat tjera. Për ne, ky fakt nuk është as kontestues përdërisa vet AK nuk ka publikuar letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE 'TSR' shpk.


AK ka anuluar lotin 6 të AP me arsyetimin se nuk janë ngarkuar oferta të përgjegjshme mirëpo nuk janë bashkangjitur letrat standarde ku evidentohen arsyet për eliminimin e ofertave të dorëzuar dhe kërkesat e DT që pretendohet se nuk janë përbushur.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.06.2025


Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.